



Breaking News:

Raporti i ngjarjeve, 7 korrik 2024  
PKK Hani i Hotit – Nuk deklaruan rreth 84 000 euro, procedohen penalisht 2 shtetas polakë  
PKK Morinë – Goditen në hyrje të Shqipërisë, 1 rast i kontrabandimit të ilaçeve dhe 1 rast i mosdeklarimit të të hollave  
Vlorë – Vihen në pranga 2 shtetas të shpallur në kërkim për prodhim dhe shitje të narkotikëve  
Divjakë – Vihet në pranga 1 shtetas, në kërkim djali i tij



Lajmet

Operacionet

05/07/2024

# Elbasan – Finalizohet Operacioni I Koduar “Second”, Kundër Armëmbajtjes Pa Leje

Elbasan

Policia e Elbasanit finalizoi brenda 24 orësh, një tjetër operacion kundër armëmbajtjes pa leje.

Si rezultat i operacionit të koduar “Second”, u sekuestruan 1 armë zjarri kallashnikov, 2 krehra dhe 30 fishekë luftarak.

Arrestohet në flagrancë 21-vjeçari që lëvizte në një rrugë të fshatit Gjinar, me armën dhe municionin, në çantë.

Në vijim të punës së pandërprerë, me objektiv garantimin e sundimit të ligjit në territor, si dhe si rezultat i administrimit të menjëhershëm të informacioneve të siguruara nga intelijenca policore, se një shtetas lëvizte i armatosur, në fshatin Gjinar, Komisariati i Policisë Elbasan organizoi dhe finalizoi operacionin policor të koduar “Second”.

Gjatë operacionit u kap në flagrancë dhe u vu në pranga poseduesi i armës dhe i municionit, shtetasi K. B., 21 vjeç, banues në fshatin Shelcan. Nga kontrolli në çantën e tij, u gjetën 1 armë zjarri kallashnikov, 2 krehra dhe 30 fishekë luftarak, që posedoheshin pa leje.

Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, për veprime të mëtejshme.

Kërko

Enter a word for search



Komisariati Dixhital

GET IT ON  
Google Play

Download on the  
App Store

Arkiva

Select Month ▾

Linqe

- > [Arkiva](#)
- > [Akademia e Sigurisë](#)
- > [Ministria e Brendshme](#)
- > [Agjencia e Mbikëqyrjes Policore](#)
- > [Interpol](#)
- > [Europol](#)
- > [Misioni PAMECA V](#)
- > [SCPA](#)
- > [Projekti Trivalent](#)

◀ Skrapar – Vijon megaoperacioni “Territor i pastër”, asgjësohen 342 bimë cannabisi

Divjakë – Vihet në pranga 1 shtetas, në kërkim djali i tij ▶